

VENDIM
Nr. 685, datë 6.11.2024

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 408, DATË 13.5.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZHVILLIMIT TË
TERRITORIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në tekstin e rregullores së zhvillimit të territorit, bashkëlidhur vendimit nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas pikës 3, të nenit 6, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Ndërtimi i çatave të pashfrytëzueshme në zonat rurale, duke respektuar standardet teknike të miratuara nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit.”.

Neni 2

Nënndarja “vi”, e pikës 2.2, të nenit 6/1, shfuqizohet.

Neni 3

Në nënndarjen “xi”, të pikës 3, të nenit 7, pas fjalëve “... ndërtimi i çatave të pashfrytëzueshme ...” shtohen “... në zonat urbane ...”.

Neni 4

Pas pikës 4, të nenit 9/1, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Për lejet e zhvillimit që miratohen nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, në rastet e aksesit në tokat në pronësi të shtetit, që nuk janë të zëna me objekt dhe që nuk janë në administrim të institucioneve shtetërore, si dhe të patransferuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore, leja e zhvillimit përmban edhe aksesin në këto pronë, me përjashtim të pronave shtet për llojin e resursit “arë”, “ullishtë”, “pyll” dhe “kullotë”, pa pasur nevojë për një miratim nga pronari shtet.”.

Neni 5

Pas pikës 2, të nenit 13, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Nëse ndryshon pronësia e shumicës së pjesëve/aksioneve të shoqërisë tregtare, në favor të së cilës është lëshuar leje ndërtimi, subjekti zhvillues njofton nëpërmjet sistemit *e-Leje* autoritetin e zhvillimit të territorit që ka miratuar lejen. Për lejet në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, njoftimi i drejtohet sekretariatit të KKT-së. Për efekt njohës, autoriteti përkatës i bën me dije subjektit zhvillues, nëpërmjet sistemit *e-leje* konfirmimin për vijimin e punimeve.”.

Neni 6

Pas pikës 5, të nenit 19, shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Në rastet e aksesit në tokat në pronësi të shtetit, që nuk janë të zëna me objekt dhe që nuk janë në administrim të institucioneve shtetërore, si dhe të patransferuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore, leja e ndërtimit përmban edhe aksesin në këto prona, me përjashtim të pronave shtet për llojin e resursit “arë”, “ullishtë”, “pyll” dhe “kullotë”, pa pasur nevojë për një miratim nga pronari shtet.”.

Neni 7

Pas nenit 27/2 shtohet neni 27/3, me këtë përmbajtje:

“Neni 27/3

Në rastet e parashikuara në pikën 2/1, të nenit 13, të kësaj rregulloreje, kur subjekti zhvillues nuk ka paraqitur më parë kërkesën për njoftim sipas përcaktimeve të kësaj dispozite, autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit ka të drejtë të refuzojë lëshimin e certifikatës së përdorimit.”.

Neni 8

Dispozitë kalimtare

1. Detyrimet sipas neneve 5 dhe 7, të këtij vendimi, zbatohen vetëm për lejet e ndërtimit që do të miratohen pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Agjencia e Zhvillimit të Territorit merr të gjitha masat për të parashikuar aksesin në pronë për lejet e zhvillimit dhe ndërtimit, sipas neneve 4 dhe 6, të këtij vendimi, për të gjitha vendimmarrjet e Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, që konfirmohen pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit për miratimin e standardeve teknike të nevojshme për ndërtimin e çative të pashfrytëzueshme brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama